



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 141 prot.

Kamëz, më 19.11.2021

V E N D I M

Nr. 113 Datë 19/11 2021
MBI

MBI NJË SHITESË DHE NDRYSHIM NË VKB Nr. 55 DATË 20.12.2019.

“PËR SISTEMIN E TAKSAVE DHE TARIFAT VENDORE NË BASHKINË KAMËZ”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot më 19.11.2021 në kushte të veçanta si pasojë e masave të ndërmarra për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19 , pasi mori në shqyrtim **Projekt-Vendim Nr.103 Datë 16.11.2021** në mbështetje të; Ligjit nr. 44/2015“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; Ligjit nr.139/2015“ Për Vetëqeverisjen Vendore”; Ligjit nr. 6872017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”;Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006“Për Sistemin e Taksave Vendore” të ndryshuar; Ligjit nr. 10279,datë 25.05.2010“Për kundravajtjet administrative”, i ndryshuar. Ligjit Nr.9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme” i ndryshuar; Ligjit Nr.107/2014“Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”i ndryshuar;VKM Nr.408 datë 13.05.2015“Për Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” i ndryshuar; VKM Nr. 894, datë 4.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore”, VKB nr. 55 datë 20.12.2019 të ndryshuar, **Këshilli Bashkiak Kamëz”;**

V E N D O S I:

1. Miratimin “Mbi një shtesë dhe ndryshim në VKB Nr. 55 datë 20.12.2019”.

Tek kategoria **F.SHKELJET AMINISTRATIVE DHE DËNIMET**, sa i përket Pikës, 9 (germa‘E’) “ Të Vendimit nr. 55,datë 20.12.2019,“Për Sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Kamëz” të Këshillit Bashkiak Kamëz të ndryshuar u vendosën ndryshimet si më poshtë vijon:

Ishte: Për zbatimin e këtyre penaliteteve ngarkohen të gjitha Drejtoritë respektive në Bashkinë Kamëz sipas funksioneve përkatëse.

Bëhet: Për zbatimin e këtyre penaliteteve ngarkohen të gjitha Drejtoritë respektive në Bashkinë Kamëz sipas funksioneve përkatëse.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

(Shtohet pjesa) Për vjeljen e gjobave të vendosura nga IVMT, ngarkohet Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Kamëz.

2. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga **Prefekti i Qarkut Tiranë**.

Kryetar Këshilli
Hysen Koldashi

